



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.21, datë 25.06.2020

“Për miratimin e planit strategjik dhe vjetor për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020”

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja (j), të nenit 63, pika 2 të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 11, pika 1 dhe pika 4, shkronja “a” të Rregullores “Për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendim Qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 16, datë 30.04.2020, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të audituesit të brendshëm të kontraktuar “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k”, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet audituesi i brendshëm “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k” për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar